



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË**

**DREJTORIA E PYJEVE, KULLOTAVE DHE BUJQËSISË  
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr. 820/prot.

B.Curri, më 12.2.2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ .2024

**Për miratimin ne parim te dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore-kullimore , për zhvillim të projektit “ECO-ENERGY” 100 MW Dushaj T’Plan në zonën e Bashkisë Tropojë.**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 “ Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.7/2017 “Per nxitjen e perdorimit të energjisë nga burime e rinovueshme”, Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, në VKM nr.134 datë 03.03.2021 “Për disa ndryshime në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit. dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, në VKM nr.591 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM nr.592 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, dhe në Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” mbështetur në VKB nr.83 datë 08.09.2021 , në përgjigje të kërkesës nr.153 prot. datë.13.02.2024 drejtuar bashkisë Tropojë nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “E U GREEN ENERGY sh.p.k. & WINPHARMA” sh.p.k. “Kërkesë për dhënie në përdorim të territorit pronë publike për ndërtim Park Energjetik me Erë” “DUSHAJ T’PLAN Wind” për prodhim energjie elektrike në zonën e kurrizit kodrinor të majës së Krasniqes, maja e Fluturës, T’Plan, maja e Bogdanit, maja e Gjatë , në ekonominë pyjore “ Lugina e T’Planit” pronë e Bashkisë Tropojë,

**I Propozojme Këshillit te Bashkisë Tropojë :**

1.Të miratojë në parim kërkesën për : Dhënie në përdorim me qëllim zhvillim projekti të territorit për ndërtimin e Parkut Energjetik me Erë “DUSHAJ T’PLAN Wind”, për prodhim energjie elektrike , në zonën e kurrizit kodrinor të majës së Krasniqes, maja e Fluturës, T’Plan, maja e Bogdanit, maja e Gjatë ,

në ekonominë pyjore “Lugina e T’Planit” pronë e Bashkisë Tropojë.

Dhënie e lejes për ndërtimin e parkut colik me fuqi të instaluar 100MW në të cilën instalohen 50 kulla areogeneratori me fuqi 2.0 MW secila është 77500 m<sup>2</sup>.

2. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Bujqësisë, dhe Zyra Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”).

Konceptoi: S.Murataj  
Pranoi: K.Baliaj  
Ligjshëmria: M.Gjoni

**KRYETARI**

**Rexhe BYBERI**

**NE MUNGESHE DHE ME POROSI**

**ZV/KRYETARI**

**ABEDIN KERRNAJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË**

**DREJTORIA E PYJEVE, KULLOTAVE DHE BUJQËSISË  
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr. 870/2 prot.

B. Curri, më 22.2.2024

**Relacion**

**Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për zhvillim të projektit “ECO-ENERGY” 100MW në zonën e Dushaj T Plan pronesi e Bashkisë Tropojë.**

**Drejtuar: Këshillit të bashkisë Tropojë**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Tropojë në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj , ndër të cilat është dhe administrim - menaxhimi i fondit pyjor- kullosor bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, ka në pronësi një sipërfaqe të përgjithshme prej 49770.91 ha. Pjesë e administrim – menaxhimit është dhe dhënia në përdorim /me qera e këtij fondi për ushtrim aktivitetesh të ndryshme nga persona fizik ose subjekte konform legjislacionit të pyjeve e kullotave.

**Baza ligjore:**

- Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Ligji nr.8480 datë 27.5.1999 “ Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
- Ligji nr.107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime e rinovueshme”.
- Ligji nr.57/2020 “Për pyjet”.
- VKM nr.134 datë 03.03.2021 “Për disa ndryshime në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” VKM nr.591 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.
- VKM nr.591 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat

e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

- VKM nr.592 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”.
- Udhëzimi nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.
- 

**Nisur nga kërkesa e ardhura nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “E U GREEN ENERGY sh.p.k. & WINPHARMA” sh.p.k. me nr.153 prot, date 13.02.2024**

prot. datë.13.02.2024 drejtuar bashkisë Tropojë.“Kërkesë për dhënie në përdorim të territorit pronë publike për ndërtim Park Energjetik me Erë”, dhe konfirmimit mbi dakortesine e zhvillimeve te projekteve me energji e eres ne territorin Fond Pyjor / Kullësor Publik ne Bashkine Tropoje te miratuara ne Vendimet e Keshillit Bashkiak dhe Bashkise Tropoje ne vitin 2021 me Nr.154 prot, date 13.02.2024 protokolluar prane Bashkise Tropoje me Nr.821, date 13.02.2024 ku deklaroi dhe deklaroi dakortesine per zhvillimin e projektit vetem ne zonen Dushaj Tplan Nr.83 date 28.09.2021, konfirmimin nga Perfekti Qarkut Kukes me aktin nr.2/76 prot, date 15.10.2021. Sikunder deklaroi dhe konfirmon terheqjen nga kerkesat e meparshme referuar Vendimeve te Keshillit Bashkiak Nr. 84, 85 date 28.09.2021 nr. 1835/6 prot dhe nr.1835/5 date 15.10.2021 “Per miratimin e dhenies ne miratim per qellim studimi te territorit per ndertim Park Energjetik me Ere “Rexhaj Wind” dhe “Kepenek Wind” ne territorin e Bashkise Tropoje.

-“DUSHAJ T’PLAN Wind” me sipërfaqe 12.2 km për prodhim energjie elektrike në zonën e kurrizit kodrinor të majës së Krasniqes, maja e Fluturës, T’Plan, maja e Bogdanit, maja e Gjatë , një stacion në ekonominë pyjore “ Lugina e T’Planit” me koordinata X 4420647.592 Y 4681919.150 : X 442522.777 Y 4681107.307 : X 4426657.914 Y 4686087.933 : X 4427886.871 Y 4685974.999 : X 4427034.881 Y 4679968.487 : X 4423639.363 Y 4679966.331, X 4421128.039 Y 4680737.918 dhe stacioni tjetër në ekonominë kullësore “ Lugina e T’Planit” pronë e Bashkisë Tropojë.

Rruget e aksesit

Hyrja ne kantier 1 : X 502131.070 Y 4681444.800 :

X 505604.640 Y 4682278.390 :

X 504716.670 Y 4680596.440 :

X 507194.670 Y 4679708.840 :

X 509007.680 X 4684464.640

Sipërfaqja territoriale e përgjithshme prej 77500 m<sup>2</sup> per kryerje studimi Anemologjik te zones nga ku do te klasifikohet sheshndertimi i parkut eolik, eshte marre ne perdorim me Vendim nr. 83, date 28.09.2021 te keshillit Bashkiak Tropoje.

Sipërfaqja e ndertimit te parkut eolik per fazen e pare te instaluar 100MW, ne te cilen instalohen impjanti energjetic me ere i perbere nga 50 kulla aerogeneratori me fuqi 2.0 MW secila, te lidhura elektrisht nepermjet tyre dhe n/stacionit elektrik te parkut me rrjet kabllor te shtrire nentoke pa kanale betoni, dhe sipërfaqja e përgjithshme per zhvillim do te merret me qera afatgjate deri ne 10 vite eshte 77500m<sup>2</sup> ne Pronesi te Bashkise Tropoje.

Bashkëlidhur dokumentacioni :

-Për secilën kërkesë i skanuar (Kopje të Çertifikatës së rregjistrimit të shoqërisë, Kopje të planvendosjes së parkut energjitik eolik “Relacion Teknik të stacionit Anemometrik parku energjitik me erë eolik DUSHAJ TPLAN Wind”.

-Hartat e ekonomive pyjore ku do jepen sipërfaqet për zhvillim projekti .

-Ngastrat pyjore sipas Kadastres pyjore-kullosore pronë e Bashkisë Tropojë të sipërfaqeve që do jepen në përdorim.

Bazuar në sa më sipër **Propozojmë miratimin e dhënies me qera afat dei në 10 vite për për zhvillim të projektit “ECO-ENERGY” 100MW në zonën e Dushaj T Plan pronesi e Bashkisë Tropojë dhe ndërtim Park Energjitik me Erë sipas të dhënave të mësipërme.**

**Konceptoi:** S.Murataj

**Pranoi:** K.Baliaj

